

VENDIM
Nr. 1049, datë 23.12.2015

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
BERAT, TË OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, TË
PRONËS NR. 1045, ME EMËRTIM “OBJEKTI I ISH-REPARTIT USHTARAK NR.
9910”, ME VENDNDODHJE NË LAGJEN “DONIKA KASTRIOTI”, BERAT, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Berat, të objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 37 580 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) m², të pronës nr. 1045, me emërtim “Objekti i ish-repartit ushtarak nr. 9910”, me vendndodhje në lagjen “Donika Kastrioti”, Berat, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për krijimin e kushteve të shërbimit të varrimit për zgjerimin e varrezave publike të qytetit Berat.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1045, me emërtim “Objekti i ish-repartit ushtarak nr. 9910”, me vendndodhje në lagjen “Donika Kastrioti”, Berat, sipas objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 37 580 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) m², dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të llojit varreza publike, që i janë transferuar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Berat.

3. Bashkisë Berat i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Berat, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SISTEMI KOORDINATIVE SHITETERORE



500

1

508

400

100



205

1

508

300	
200	

207

Ripunuar Tetor 2015

442 700

442 TOE